

VENDIM
Nr. 177, datë 27.3.2024

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.11.2023, PËR ÇËSHTJEN “DURDAJ DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 63543/09 DHE 3 KËRKESA TË TJERA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.11.2023, për çështjen “Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për kërkesën nr. 63543/09 (Durdaj), nr. 46707/13 (Selami), nr. 46714/13 (Durdaj dhe Hazizaj), nr. 12720/14 (Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj), përfundimtar në datën 7.2.2024, sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuësve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.11.2023, “Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 63543/09, për secilën kërkesë.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të të gjithë kërkuësve nr. 63543/09 (Durdaj), nr. 46707/13 (Selami), nr. 46714/13 (Durdaj dhe Hazizaj), nr. 12720/14 (Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afati 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, për shumat e përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të paguhet interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%.

6. Efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2024.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E KËRKUESVE DHE SHPËRBLIMI I DREJTË

Numri i kërkesës	Emri i Çështjes	Kërkuesit	Dëm jopasuror	Kostot dhe shpenzimet ¹
63543/09 12720/14	Durdaj kundër Shqipërisë	Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj	12 000 (dymbëdhjetë mijë) euro bashkërisht	
46707/13	Selami dhe të tjerë kundër Shqipërisë	Aishe Selami Pashk Kaçi Mirela Hazizaj	-10 000 euro -10 000 euro -10 000 euro	
		Miselda Zguri Medi Celami Rabie Gërdeci Shaban Brahushi Sabrie Picari Dylbere Prini Adelina Cani	-10 000 euro -10 000 euro -10 000 euro -10 000 euro -10 000 euro -10 000 euro -10 000 euro	8 000 (tetë mijë) euro bashkërisht për të gjithë kërkuesit
		Meltina Haka Bege Aliu Esmeralda Sefaj	-10 000 euro -10 000 euro -10 000 euro	
46714/13	Durdaj dhe Hazizaj kundër Shqipërisë	Roxhens Durdaj Alketa Hazizaj	20 000 (njëzet mijë) euro bashkërisht	

¹ Plus cdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet

46707/13	Selami dhe të tjerë kundër Shqipërisë	Aishe Selami	-10 000 Euro	8 000 (tetë mijë) Euro bashkërisht për të gjithë kërkuesit
		Pashk Kaçi	-10 000 Euro	
		Mirela Hazizaj	-10 000 Euro	
		Miselda Zguri	-10 000 Euro	
		Medi Celami	-10 000 Euro	
		Rabie Gërdeci	-10 000 Euro	
		Shaban Brahushi	-10 000 Euro	
		Sabrie Picari	-10 000 Euro	
		Dylbere Prini	-10 000 Euro	
		Adelina Cani	-10 000 Euro	
		Meltina Haka	-10 000 Euro	
		Bege Aliu	-10 000 Euro	
		Esmeralda Sefaj	-10 000 Euro	
46714/13	Durdaj dhe Hazizaj kundër Shqipërisë	Roxhens Durdaj	20 000	(njëzet mijë) Euro bashkërisht
		Alketa Hazizaj		